



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

**Legjislatura III**

**Sesioni pranveror**

**Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion**

Mbledhja nr. 14/2010

Prishtinë më 30.03. 2010, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

**PROCESVERBAL**

**I mbledhjes së Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion**

**Në mbledhje morën pjesë:** Myzejene Selmani - kryetare, Ethem Çeku, Fatmir Rexhepi, Sala Berisha – Shala, Mursel Halilji, Qamile Morina, Kaqusha Jashari, Zef Morina dhe deputetët e pavarur: Emrush Xhemali dhe Bujar Dugolli.

**Munguan:** Mufëra Şinik dhe Nerxhivane Dauti.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Justina Shiroka – Pula dhe Faki Nahi - MEM, Bajram Gecaj, Michail Bord, Arben Nagavci dhe Haxhi Gashi – USAID, Mark Hughes e Lorik Haxhiu - LPTAPPO, Azem Rexhaj e Ahmet Tmava - KPMM, Rrezarta Ahmetaj – KDI dhe Ibrahim Krasniqi - konsulent.

**Nga Stafi Mbështetës:** Hasan Tahiri, Advije Morina, Armend Ademaj dhe Besim Haliti.

**Mbledhjen e kryesoi:** Myzejene Selmani, kryetare.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

**R e n d i d i t ë s**

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbaleve të 23. 03. 2010 dhe 26. 03. 2010,
3. Rishqyrtimi i Propozimstrategjisë së energjisë për periudhën 2009 – 2018,
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 03/L-163 për miniera dhe minerale,
5. Të ndryshme.

## **I. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua duke hequr pikën 4 ( katër): « Shqyrtimi i Projektligjit nr. 03/L-163 për miniera dhe minerale » për shkak të ngarkesës.*

## **II. Miratimi i procesverbaleve të 23. 03. 2010 dhe 26. 03. 2010**

**Sala Berisha-Shala** - Tha se në procesverbalin e 23. 03. 2010 kanë mbetur të përgjysmuara komentet dhe arsyeshmëria e amendamentimit të nenit 59, që ka të bëjë me Shërbimin Gjeologjik të Kosovës, e që do t'ia përcjellë zyrës mbështetëse të Komisionit.

*Me vërejtjen e Sala Berisha – Shala procesverbalet u miratuan.*

## **III. Rishqyrtimi i Propozimstrategjisë së energjisë për periudhën 2009/2018**

**Myzejene Selmani** - Ua përkujtoi të pranishmëve se më 18 mars, në seancën e Kuvendit është shqyrtuar Strategjia e energjisë për 2009 - 2018 dhe ka përfunduar me rekomandimin se Komisioni për ETIETT duhet të rihartojë rekomandime shtesë për Strategjinë 2009 - 2018. Në vazhdim fjala iu dha ministres së MEM - it, Justina Shiroka - Pula.

**Justina Shiroka – Pula ( ministresh e MEM-it)** - ajo tha se bashkë me përfaqësuesit e Komisionit për transaksion jemi të gatshëm, që në pyetjet tuaja të japim sqarime dhe komente me qëllim të rihartimit të rekomandimeve plotësuese.

**Mark Hughes (Këshilltar i Komisionit për Transaksion)** – E arsyetoi në parim Strategjinë e propozuar nga Qeveria, e sidomos të Projektit të TC “Kosova e Re”.

**Ethem Çeku** – Ua rikujtoi të pranishmëve se kërkesa kryesore e Kuvendit lidhur me Projektstrategjinë e vitit 2009 -2018 të hartohen rekomandime, të cilat do ta plotësojnë dhe përmirësojnë vizionin zhvillimor të ekonomisë kosovare, e në veçanti të sektorit të energjisë. Ai theksoi, veç të tjerash, se në parim jemi për privatizim, vetëm duke respektuar parimin e konkurrencës. Në vazhdim ai tha se TC “Kosova B” duhet të mbetet jashtë pakos tenderuese të TC “Kosova e Re” për shumë arsye. Nuk janë bërë studime të mjaftueshme për arsyeshmërinë ekonomike të përfshirjes ose të mos përfshirjes në pakon tenderuese. Për TC “Kosova B” mund të planifikohen investime përmes formës së partneriteti publik e privat, që do prodhonte efekte pozitive, siç janë: mbrojtja - përmirësimi i politikës sociale, eliminimi i monopolizimit të tregut, krijimi i parakushteve për një konkurrencë të lirë dhe të hapur, e tjera.

Shfrytëzimi i Minerës së Sibovcit është ende i padefinuar nga se nuk ka përgjigje se jepet në tërësi ose pjesërisht. Ai vlerësoi, veç të tjerash, se Miniera e Sibovcit mund dhe duhet të jepet në raport me nevojat e kapaciteteve gjenerues dhe në pajtim me Ligjin përkatës. Dhe parashtrroi pyetjen se a janë bërë studime analitike të mjaftueshme për të gjitha projektet konkrete, duke përmendur, privatizimin e TC “Kosova B”; distribuimin dhe furnizimin me energji.

**Fatmir Rexhepi** - Tha se ne, si Komision, ose Kuvend, duhet të debatojmë lidhur me Strategjinë, e kurrresi për modelet - projektet e Qeverisë ose ministrisë në zbatim të Strategjisë afatgjate për energji. Është në përgjegjësi të Qeverisë t'i zbatohet dhe t'i përmbushi kërkesat dhe vizionet që dalin nga Strategjia.

Sipas tij Strategjia duhet të përcaktojë vizionin e një zhvillimi të tregut konkurrent, të parandalojë monopolin dhe të përcaktojë parashikimet e zhvillimit të energjisë, me qëllim të përmbushjes së kërkesave, si dhe të zhvillimit të përgjithshëm ekonomik. Ai mori si shembull: Kosovës deri në vitet 2020 - 2030 i nevojiten kapacitetet gjeneruese të një niveli të caktuar dhe pastaj të mbeten si detyra të Qeverisë për përcaktimin e fazave, kapaciteteve, formave dhe modeleve të realizimit të tyre.

Meqenëse tani po debatohet edhe për veprimet konkrete të Qeverisë, veç të tjerash tha se "Kosova B" nuk duhet të përfshihet në pakon tenderuese të privatizimit me "Kosovën e Re", nga se edhe në Strategjinë e energjisë nuk është paraparë, ndërsa kapacitetet gjeneruese të "Kosovës së Re" të jenë 1000 +1000 MW.

Ai e përsëriti edhe njëherë se duhet të trajtojmë vetëm Strategjinë, të cilën Qeveria - ministria duhet ta zbërthej, përpunojë dhe në pajtim me nevoja dhe mundësitë edhe ta zbatohet e realizojë.

**Kaçusha Jashari** - Theksoi se veprimet konkretet të Qeverisë - ministrisë nuk janë në pajtueshmëri me Strategjinë, çka nuk do duhej të ndodhte. Është e qartë se Kosova ka nevojë për më shumë energji, mirëpo të gjitha këto kërkesa do duhej të përcaktoheshin në Strategji. Tani disa gjëra kanë marrë rrjedhë konkrete, pa respektuar dhe në kundërshtim me Strategjinë e energjisë. Sa i përket privatizimit të resurseve tha se do duhej që shteti në pajtim të ketë asetet e veta në secilën pronë publike. Për të ishte edhe e palejueshme që TC "Kosova B" të përfshihet në pakon e tenderimit, së paku për momentin, gjersa në Strategjinë e energjisë nuk parashihet.

**Qamile Morina** - Shprehu dyshimin për profitabilitetin ekonomik të të gjitha këtyre veprimeve konkrete të Qeverisë për përfshirjen e TC "Kosova B" në pakon e tenderimit të TC "Kosova e Re", pastaj të ndërtimit të kapaciteteve gjeneruese pa ndonjë analizë më serioze dhe bindëse. Gjithashtu, sipas saj, janë të paarsyeshme dhe të paqëndrueshme veprimet konkrete të Qeverisë, derisa projektet konkrete nuk mbështeten në Strategjinë e energjisë.

**Zef Morina** – Edhe sipas tij, çështje që meriton trajtim të veçantë është TC "Kosova B" dhe fati i saj i ardhshëm. Unë tha nuk jam kategorik që "Kosova B" të mbetet jashtë tenderimit, nga se mungojnë analizat për profitabilitetin ekonomik për njërin ose formën tjetër. Sipas tij Kosova ka nevoja të brendshme që të ndërtojë kapacitete gjeneruese prej 1000 MW. Ai një pjesë të diskutimit ia kushtoi edhe pjesëmarrjes së shtetit në pronën publike për mes partneritetit publiko – privat, të cilën shkallë të pjesëmarrjes duhet debatuar në bazë të një studimi analitik.

**Bujar Dugolli** – (Deputet i pavarur – pjesëmarrës i vullnetshëm), sipas tij shqetësimet janë ngritur rreth aseteve konkretisht në TC "Kosova B". Ai tha se ka krijuar përshtypjen nga seanca se Kuvendi është kundër përfshirjes së "Kosova B" në kuadër të

tenderimit të privatizimit. Shqetësimi është ngritur edhe rreth pjesëmarrjes së aksioneve në Kompaninë e Re, në mënyrën e eksploatimit të minierës, rreth çështjeve të mjedisit, se “Kosova e Re” do të jetë pranë B - së ose A - së. Ka pasur kërkesa që të jetë pranë A - së. Unë mendoj sikurse edhe institucionet e Kosovës, se ne kemi nevojë për kapacitete të reja energjetike. Ai tha se Qeveria e ka për detyrë të gjejë zgjidhjen më të mirë të mundshme, duke llogaritur edhe në interesin e investitorit, sepse është e qartë se edhe investitori, si qëllim primar e ka interesin. Qeveria e Kosovës nuk duhet të jetë në presion të kritikave dhe të marrë vendime që ndoshta mund të jenë të dëmshme”. Ai tërhoqi vërejtjen se në rast se nuk sqarohen çështjet që janë ngritur në Kuvend, Qeveria mund të marrë vendime të përshpejtuara, të cilat edhe nuk do jenë në interesin e përgjithshëm. Ai apeloj te këshilltarët ndërkombëtarë, që deri me tani e kanë ndihmuar Kosovën, këtë ta bëjnë edhe më tej, e sidomos në rastin konkret. Ai vlerësoi se u jemi mirënjohës shteteve që e kanë ndihmuar Kosovën dhe janë të mirëpritura edhe investimet e tyre, por të gjendet një balancë që do të jetë në interes edhe të vendit edhe të investitorëve, përfundoi Dugolli.

**Myzejene Selmani** – Theksoi se veprimet konkrete të Qeverisë nuk duhet të shmangen nga Strategjia e energjisë, projektet duhet të jenë të precizuara dhe sa ma transparente, e sidomos, çështja e projektit “Kosova e Re”, “Kosova B”, si dhe privatizimi i distribucionit dhe i furnizimit, që të shkojnë paralelisht njëri me tjetrin. Tani shtrohet pyetja kemi ligje të kompletuara për këto çështje? Ne, si Komision, kemi rekomanduar dhe kërkuar që “Kosova B” të jetë jashtë pakos së tenderimit, çka do duhej edhe tani të përsëritej. Ishte e mendimit se Strategjia e energjisë do duhej të përmbante përcaktimet bazë të kaheve zhvillimore të energjisë, ndërsa projekt - programet brenda kornizave të Strategjisë, e që nuk po ndodh me veprimet e Qeverisë.

**Ali Hamiti (ZRRE)** – Tha se Komisioni duhet të përqendrohet me diskutimet e veta në çështjet diskutabile që kanë rezultuar në seancën e Kuvendit, me qëllim për të dhënë përgjigje dhe rekomandime. Është tepër e rëndësishme edhe për projektin, edhe për Kosovën që Strategjia të miratohet dhe zbatohet. Mendojë se për 8 vjetët e ardhshëm, sa kanë mbetur për këtë Strategji, me siguri se veprimet e Qeverisë, jo gjithëherë do të kenë bazën dhe mbështetjen e plotë në Strategji, ashtu siç po veprohet në rastin konkret për projektin “Kosova e Re”, ose çfarëdo projekti tjetër, qoftë ai i vetëm ose me “Kosovën B”; si do të shfrytëzohet miniera, a do të jetë e vetme; çfarë do të jenë aksionet e Kosovës në projektin si tërësi ose në “Kosovën B”, me gjenerim veçmas në miniera, e të tjera. Tani është evidente që disa ecuri të projektit nuk po shkojnë krejtësisht në harmoni me strategjinë e propozuar dhe me pikat që janë thënë në Strategji deri në vitin 2018. Mendojë se këto janë edhe më tutje çështje të hapura për të cilat në fund të fundit Qeveria duhet të vendos, por kjo të jetë në harmoni me Strategjinë. Ai tha se edhe për të janë disa paqartësi, nga se ju në parim e keni miratuar Strategjinë dhe tani si duket ju po i trajtoni veprimet konkrete të Qeverisë. Edhe unë tha pajtohem se diçka që është zhvilluar anash e që nuk është përshkruar me Strategjinë, është problem i Qeverisë. Pse shkon kundër strategjisë e cila ende nuk është miratuar, apo imponon ta ndryshojë atë strategji, duke ua imponuar që ju ta doni disi ndryshe atë strategji e që do të përkonte me një projekt që është njëherit në ndërtim e sipër? Mendojë se në prioritetet duhet të kemi krijimin e kushteve për investime, por ato të jenë gjithësesi në dobi të Kosovës, të sektorit, dhe

natyrisht të jenë në harmoni me politikat e Qeverisë afatmesme dhe afatgjata. Përderisa strategjia është në procesin e miratimit, unë mendoj që e mira e së mirës është që vetëm ato pika, ku ju, ose mendoni se duhet ta adaptoni Strategjinë me projektin, ose projekti duhet të shpjegohet sipas Strategjisë, pra njëra ose tjetra, nuk ka tjetër. Kështu që unë mendoj se Strategjia është afatgjate dhe në Strategji afatgjate gjithëherë duhet të shikohet interesi afatgjatë i Kosovës, gjithsesi veçanërisht në sektorin e energjisë. Në pyetjen e parashtruar lidhur me analiza studimore tha se deri më tani, nuk ka një vlerësim të saktë se si dhe kur do të ndodhte privatizimi, çka do të fitonte dhe çka do të humbte Kosova.

**Sala Berisha - Shala** – Tha se ne e kemi analizuar Strategjinë dhe përafërsisht jemi pajtuar të gjithë me këtë dokument, por kemi dilema në hapat që janë duke u hedhur jashtë asaj që parashihet me këtë dokument. Ajo vlerësoi se ndërmjet anëtarëve të Komisionit ka disharmoni për çështjet që janë të dorës së dytë. Ndërsa është një përafrim i mendimeve në çështjet më kapitale për Strategjinë e energjisë. Ajo në vijim u përqendrua në projektet konkrete të Qeverisë dhe të arsyeshmërisë e tyre. Në vazhdim tha se kemi pasur nevojë për sqarim, se cili është i ashtuquajti kosto - benefiti i “Kosovës B”, brenda ose jashtë pakos tenderuese, pastaj raporti i Minierës së Sibovcit me “Kosovën e Re”. Prapë për mua shtrohet pyetja se si do të jetë e rregulluar përqindja e aksioneve në “Kosova B” në pakon tenderuese? Megjithatë ajo vlerësoi se është duke u kryer punë e mirë në institucionet përgjegjëse, andaj duhet edhe të pajtohemi, ngase Kuvendi ua ka besuar edhe përgjegjësitë. Nisur nga ky vlerësim tha se pajtohet me projektin e Qeverisë për “Kosova e Re” 500 + 500 MW me tendencë të rritjes me qëllim që t’i plotësojë nevojat e vendit duke pasur parasysh edhe mbrojtjen e ambientit, rekomandime që dalin nga Konferenca e Kopenhagës. Sa i përket projektit të shfrytëzimit të Minierës së Sibovcit, tha se do të bëhet në pajtim me Ligjin për miniera e minerale, e që është në përfundim të miratimit.

**Ahmet Tmava (KPMM)** – Tha se është diskutuar kjo çështje, dhe KPMM - ja do të jetë zbatuese e ligjit dhe ne besojmë që Licenca për Minierën e Sibovcit nga KPMM - ja do jepet vetëm në pajtim me dinamikën dhe projektin e paraparë. Ne kemi dhënë mendimin se jashtë projektit eksploatues nuk mund t’i jepet monopoli mbi minierën askujt, duke apostrofuuar kohën dhe tregun që rregullon gjithçka.

**Justina Shiroka - Pula** – Tha se Strategjia në parim është miratuar me disa kërkesa. Ndërkohë edhe këtu u vërejtën se procesi i zhvillimit të Termocentralit Kosova e Re është duke u dizajnuar në atë mënyrë, që disa çështje nuk janë të detajizuara në Strategji. Propozimi rreth Termocentralit Kosova e Re ose disenjimi i Termocentralit Kosova e Re, është bërë më ndihmën e Këshilltarëve të Transaksionit, si tha z. Çeku, që 2 - 3 vjet edhe Këshilltarët e Transaksionit kanë dhënë opsione të ndryshme në atë kohë, diku kah korriku, kur është bërë faktikisht ky dokument strategjik dhe tani ka marrë një formë krejtësisht të re. Në Strategji Termocentrali Kosova B parashikohet të rivitalizohet me një partneritet dhe diku në vitin 2015 - 2016, kur hynë në operim Termocentrali Kosova e Re. Këshilltarët e Transaksionit kanë dhënë një propozim që në këtë transaksion të termocentralit Kosova e Re, të hyjë edhe Termocentrali Kosova B. Ne në kuadër të Komitetit Drejtues të Projektit e kemi marrë si një opsion me kusht që të analizohet dhe të shohim se sa do të përfitojë Kosova prej futjes së termocentralit Kosova B. Opcionin të

cilin e kanë propozuar Këshilltarët e Transaksionit e kemi diskutuar disa herë, prandaj edhe kanë për ta shpjeguar më mirë se si e kanë menduar futjen e Termocentralit Kosova B në pakon e tenderit të Termocentralit Kosova e Re. Edhe një herë po e ceku, ne në Komitetin Drejtues e kemi si një prej opsionit, opsionale, me kusht që të shohim se sa mund të fitojmë nga ky termocentral. Dhe nëse në Strategji parashikohet se ky do të rivitalizohet dhe duhet të përfshihet edhe pjesë e privatizimit ose tërheqjes së investitorëve, atëherë nëse në këtë periudhë mund të përfitojë pak më shumë sesa që parashikohet pas një periudhe, kemi menduar që ta fusim si opsionale. Prandaj unë mendoj se të gjitha këto propozime që i kanë dhënë Këshilltarët e Transaksionit, janë si opsione që ne në Komitetin Drejtues do t'i diskutojmë. Sipas vlerësimeve të tyre, sepse ne nuk kemi bërë vlerësime prandaj janë edhe Këshilltarët e Transaksionit, janë edhe ekspertët lartë, të cilët na propozojnë dhe na ofrojnë propozime, kurse ne në Komitetin Drejtues, pavarësisht që kemi shumë ekspertë aty, nuk kemi kohë dhe nuk mundemi të merremi me analizën e këtyre çështjeve. Janë Këshilltarët e Transaksionit bashkë me ekipin e KEK - ut, bashkë me përfaqësuesit e Bankës Botërore dhe të USAID – it, të cilët kanë kontribuar që të bëjmë një vlerësim të Termocentralit “Kosova B”. Po e ceku, ne jemi pajtuar që Termocentrali “Kosova B” mund të hyjë në pako si opsion dhe të hulumtojmë ose të hulumtojmë dhe të shohim se sa do të na ofrojë tregu. Kjo ka qenë. Unë nuk e di çka dëshironi tjetër të dini, përfundoi znj. Justina.

**Kaqusha Jashari** – Parashtrori pyetjen se cili variant është në interes të Kosovës, përfshirja apo mos përfshirja e TC “Kosova B” në pakon e tenderimit? Njëherit ajo tha se do ishte me siguri në interes të përgjithshëm kosovar, për shumë arsyeje investimi publiko -privat të cilin e mbështes sipas bindjeve të mija dhe të shumë ekspertëve.

**Qamile Morina** – parashtrori pyetjen se cilat janë përparësitë dhe jo përparësitë në të dyja rastet lidhur me “Kosova B”.

**Fatmir Rexhepi** - Tha se në Strategji duhet të përfshihet mënyra e shfrytëzimit të Minierës së linjtit, e ajo të jetë me koncesion në bazë të kapaciteteve që i ndërtojnë kompanitë, se Kosovës deri në vitin 2018 i nevojiten dhe do sigurohet gjenerim kapacitetesh prej 1000MW, të sigurohet treg dhe konkurrencë e lirë. Të gjitha këto të përfshihen në Strategji duke detyruar Qeverinë për respektim të saj, përfundoi Rexhepi.

**Qamile Morina** – Propozoi që Strategjia t'i kthehet Ministrisë për ta plotësuar e përmirësuar e pastaj të kthehet për t'u miratuar në Kuvend. Në fund Komisioni u pajtua që të hartohen rekomandimet dhe t'i dërgohen për miratim Kuvendit.

*Pas këtij debati, Komisioni i hartoi dhe i miratoi me pesë (5) vota “për” dhe me një (1) votë “kundër”, rekomandimet si vijon:*

#### *Rekomandim*

*I rekomandohet Kuvendit të Kosovës që së bashku me Strategjinë për energji për periudhën 2009-2018, t'i miratoi edhe rekomandimet në vijim, si pjesë plotësuese e startegjisë:*

- I- *Resurset e linjtit të vihen në dispozicion dhe në shfrytëzim në pajtim me kapacitetet e reja gjeneruese të energjisë dhe në harmoni me interesat zhvillimore të Kosovës.*
- II- *Që të krijohet ambient ligjor për konkurrencën dhe tregun e lirë në fushën e sektorit të energjisë.*
- III- *TC ‘Kosova B’ të mos përfshihet në pakon e tenderimit së bashku me ‘Kosovën e Re’, por të mbetet sipas dokumentit të Strategjisë.*
- IV- *Ndërtimi i kapaciteteve të reja gjeneruese të bëhet në bazë të interesit afatgjatë për Kosovën, në fazën e parë – kapaciteti 1000 MW me mundësi të ndërtimit të kapaciteteve të tjera, në harmoni me kërkesat dhe bilancin energjetik të vendit dhe të rajonit.*
- V- *Qeveria e Kosovës detyrohet ta harmonizojë Planin e Veprimit me Strategjinë e energjisë, të miratuar për periudhën 2009 - 2018.*

#### **IV. Të ndryshme**

##### **Çështje vijuese.**

Përfundoj në orën 14:30

**Përgatitur nga Njësia Mbështetëse e Komisionit**

**Kryetarja e Komisionit**

-----  
**Myzejene Selmani**